



Pranuar / Dorezuar Primi/jeho/Prodato Received/Delivety	02-05	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKSHCK	3969/2023		115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.455/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.455/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesit: .....

banimi "....." Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike-administrative "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerr akt administrativ lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 05.12.2022 dhe 13.12.2022 të parashtruar nga ankuesit,

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit ..... të punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datën 03.03.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 2291/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos ekzekutimit për orët shtesë të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 07.03.2023 ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli me datën 23.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2902/2023 bashkë me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendim VK/2023, të datës 07.04.2023, ka shtyrë edhe për dhjetë (10) ditë afatin për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me numër protokolli 2291/2023 të datës 03.03.2023; Kërkesë për pagesë shtesë për punë jashtë orarit i datës 05.12.2022; Dosja e punës jashtë orarit i datës 05.12.2022; Libri i hyrje daljeve faqe 1/4; Kërkesë për pagesë shtesë për punë jashtë orarit i datës 13.12.2022; Dosja e punës jashtë orarit i datës 13.12.2022; Libri i hyrje daljeve faqe 1/2; Vendim me numër 02-1038 i datës 18.11.2022; Vendim me numër 02-1038/2 i datës 22.11.2022; E-mail nga N. G.K për G. S i datës 13.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 25.11.2022; E-mail nga D. H për V. C i datës 25.11.2022; E-mail nga V. C për M. Sh i datës 24.01.2023; E-mail nga m. Sh për V. C i datës 19.12.2022; E-mail nga V. C për M. Sh i datës 19.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 19.12.2022; E-mail nga N. G. K për G. S i datës 13.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 09.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 09.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 23.11.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 28.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2451/2023 i datës 07.03.2023; Përgjigje në kërkesë me numër protokolli 2902/2023 i datës 23.03.2023; E-mail nga M. Sh për V. C i datës 14.02.2023; E-mail nga D. Xh për E. K etj i datës 08.02.2023; E-mail nga M. Sh për V. C i datës 07.02.2023; E-mail nga V. C për 03.02.2023; E-mail nga E. K për D. Xh etj i datës 03.02.2023; E-mail nga D. Xh për E. K etj i datës 03.02.2023; E-mail nga V. C për M. Sh i datës 24.01.2023; E-mail nga M. Sh për V. C i datës 19.12.2022; E-mail nga V. C për M. Sh i datës 19.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 19.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 13.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 12.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 12.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 12.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 12.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 12.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 12.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 09.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S i datës 09.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S etj i datës 08.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S etj i datës 08.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S etj i datës 08.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S etj i datës 08.12.2022; E-mail nga D. Xh për G. S etj i datës 07.12.2022; Kërkesë për pagesë shtesë për punë jashtë orarit i datës 05.12.2022; Dosja e punës jashtë orarit i datës 05.12.2022; Raporti i prezencës në punë o datës 03/12/2022 - 04/12/2022; Raporti i prezencës në punë i datës 24/01/2023; Libri i hyrje daljeve faqe 1/4; E-mail nga V. C për N. Xh i datës 25.11.2022; E-mail nga N. K për V. C i datës 25.11.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 25.11.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 25.11.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 28.11.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 28.11.2022; Kërkesë për pagesë shtesë për punë jashtë orarit i datës 13.12.2022; Dosja e punës jashtë orarit i datës 13.12.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 09.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. S i datës 09.12.2022; Libri i hyrje daljeve 1/2; Dosja e punës jashtë orarit i datës 05.12.2022 faqe 1/5; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 28.11.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i

datës 28.11.2022; E-mail nga V. C për N. K i datës 25.11.2022; E-mail nga N. C për V. C i datës 25.11.2022; E-mail nga V. C për D. Xh i datës 25.11.2022; E-mail nga D. Xh për V. C i datës 25.11.2022; Dosja e punës jashtë orarit i datës 13.12.2022; Libri i hyrje daljeve faqe 1/2; E-mail nga N. G.K për G. S i datës 13.12.2022; E-mail nga D. Xh për V. Xh i datës 25.11.2022; E-mail nga N. G. K për G. S i datës 13.12.2022; E-mail nga D. Xh për V.C i datës 09.12.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 13.11.2013; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 17.12.2013;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht udhëheqësin me te lartë administrativ në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që t'i ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën e datës 05.12.2022 dhe 13.12.2022 të parashtruar nga ankuesit

*1, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht Akt Emërimet e ankuesve ka konstatuar se ankuesit janë në marrëdhënie të punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të njëjtit mbajnë pozitën e punës: Nazmije Krasniqi Udhëheqëse e Divizionit për Transparencë Komunale, Monitorimit dhe Zyrtar për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit në Departamentin Ligjor.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se Ministri i Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal me Vendimin me Nr.02-1038 të datës 17.11.2022 e ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të Pushtetit Lokal për themelimin e Komisionit për Verifikim të dhënave të Komunave të raportuara gjatë procesit të raportimit për Grandin e Performancës dhe Performancës Komunale. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me datën 21.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me Nr.02-1038-2 për themelimin e Komisionit për Verifikim të dhënave të raportuara gjatë procesit të raportimit për Grandin e Performancës dhe Performancës Komunale.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesit kanë qenë të angazhuar në cilësinë e anëtarëve të Komisioni të lartpërmendur dhe të njëjtit për shkak të intervalit kohor të shkurtër kanë qenë të obliguar të punojnë jashtë orarit të punës madje edhe ditëve të vikendit dhe të festave.

Ankuesit me datë 05.12.2022 dhe 13.12.2022 kanë parashtruar kërkesë tek Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës respektivisht gjatë fundjavës dhe ditëve të festave, gjegjësisht për periudhën sa kanë qenë të angazhuar në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për datat 26, 27 dhe 28 nëntor 2022, si dhe 3, 4, 10, dhe 11 dhjetor 2022.

Sekretarja e Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 19.12.2022 përmes e-mailit zyrtar e ka përcjellë kërkesën tek zyrtarja përgjegjëse e Njesisë për Burime



Njerëzore, ndërsa kjo e fundit përmes e-mailit ju ka përgjigjur se nuk i ka proceduar pagesat për shtesa pasi që të njëjtit në këtë rast ankuesit nuk kanë vijueshmëri elektronike. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal me datën 24.01.2023 kërkon nga Menaxherja e Personelit që ti bëjë pagesat për punë jashtë orarit për zyrtarët në fjalë sepse siç thekson në emailin e datës 24.01.2023 edhe ajo në vazhdimësi ka qenë prezentë gjatë punës së tyre në fundjavë, dhe si dëshmi kanë librin e policisë ku zyrtaret në fjale janë regjistruar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Njësia për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk e ka adresuar dhe rrjedhimisht nuk i ka shqyrtuar kërkesat e datës 05.12.2022 dhe 13.12.2022 të parashtruara nga ankuesit, respektivisht nuk ka ndër marrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavës dhe festave sipas urdhrit të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se zyrtari përgjegjës i Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me rastin e mos adresimit dhe rrjedhimisht mos shqyrtimit të kërkesës sipas urdhrit të Sekretares, ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civile kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës, ..., po ashtu me nenin 21 të këtij ligji është paraparë kompensimi me pagesë ose me kohe të lirë për punë jashtë orarit.* Ndërsa me dispozitat e nenin 11 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve, është përcaktuar procedura dhe mënyra e kompensimit të nëpunësve civil për punë jashtë orarit. Po ashtu Kolegji lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referua Aktvendimit për Pranueshmëri në rastin KI37/22 të datës 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të parashtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 443/21 të datës 10 janar 2022, ku është vendosur për objektin e njëjtë si në rastin e ankueseve.

Andaj, Kolegji i Këshillit, nisur nga provat e lëndës, vlerëson se ankuesit kanë ofruar dëshmi se kanë kryer detyra të punës jashtë orarit zyrtar të punës, rrjedhimisht në këtë pikëpamje Kolegji, vlerëson se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore ka qenë e obliguar që në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe Ligjit Nr.

05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të shqyrtoj kërkesat e ankueseve dhe të nxjerr akt administrativ.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është e obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e kërkesave të datës 05.12.2022 dhe 13.12.2022 të parashtruara nga ankuesit në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.455/2023.

Sabile AVDYLI

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI,  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.